

VENDIM
Nr. 620, datë 30.7.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 861, DATË 7.12.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË–ELBASAN
(SHTESA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 861, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë–Elbasan (shtesa)”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall” “objekte” dhe “ullishte”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 42 508 427 (dyzet e dy milionë e pesëqind e tetë mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekësh, nga të cilat:

a) për pasuritë “arë” dhe “truall”, me sipërfaqe shpronësimi 10 019 (dhjetë mijë e nëntëmbëdhjetë) m², me vlerë 5 967 169 (pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë;

b) për pasuritë “objekte”, me vlerë 34 580 226 (tridhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë;

c) për pasurinë “ullishte”, me sipërfaqe shpronësimi 1 739 (një mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë) m², me vlerë 1 961 032 (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tridhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “objekte” dhe “ullishte”, prej 42 508 427 (dyzet e dy milionë e pesëqind e tetë mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”.

2. Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohen të dhënat e tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe Këshilli i Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË
SEGMENTIT RRUGOR TIRANË–ELBASAN (SHITESAT)

Nr.	Pronari			Të dhëna kadastrale sipas kartelës së pasurisë							Vlera totale (lekë)	Shënime	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Sipërfaqja e shpronësimit (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (m²)			Drufrutor
3	Zamir Rexhep Metani			2735	125/9	Ullishte	5000	1,739	399	693,861	1,267,171	1,961,032	
VLERA TOTALE												1,961,032	